

LIGJI Nr. 03/L-209

PËR BANKËN QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) dhe nenit 140 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR BANKËN QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**KREU I
PËRKUFIZIMET**

**Neni 1
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

- 1.1. **Bankë** - një subjekt i përcaktuar me Ligjin Bankar ;
- 1.2. **Banka Qendrore** - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
13. **Kushtetutë** - Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- 1.4. **Valutë** - njësia monetare e një shteti;
- 1.5. **Institucione financiare** - subjekte si banka, zyra të këmbimit valutor, kompani të sigurimeve, fonde pensionale si dhe subjekte të tjera që ushtrojnë aktivitete financiare, siç përcaktohet në ligje relevante për qëllimet e këtij ligji, për të cilat Bankës Qendrore i është dhënë autoritet mbikëqyrës me ligj;
- 1.6. **Agjent fiskal** - Banka Qendrore pa paragjykuar nenin 33 të këtij ligji, mund të kryejë transaksione, duke përfshirë dërgimin dhe pranimin e pagesave, që kanë të bëjnë me llogaritë e një subjekti në Bankën Qendrore, si dhe mund të emetojë , të riblejë dhe të servisojë bono dhe letra të tjera me vlerë të subjektit të tillë;
- 1.7. **Qeveria** - Qeveria e Republikës së Kosovës;
18. **Udhëzim** - rekomandim me shkrim i lëshuar nga Bordi Ekzekutiv;
- 1.9. **Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar** - standardet më të fundit ndërkombëtare të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit;
- 1.10. **Rezervat ndërkombëtare** - rezervat zyrtare devizore dhe rezervat e arit;
- 1.11. **Standardet Ndërkombëtare të Auditimit** - standardet më të fundit ndërkombëtare të auditimit të nxjerra nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve;
- 1.12. **Ministër** - Ministri i Ekonomisë dhe Financave në Qeveri;

1.13. **Ministri** - Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Qeverisë ;

1.14. **Urdhër** - direktiva e shkruar zyrtare të lëshuar nga Bordi Ekzekutiv për implementimin e Rregullores të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore;

1.15. **Presidenti** - kryetari i shtetit i zgjedhur sipas Kapitullit të V të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

1.16. **Kryeministër** - Kryeministri i Qeverisë;

1.17. **Rregullore** - akt nënligjor të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore;

KREU II

Neni 2 Baza ligjore

1. Duke u mbështetur në nenin 11 të Kushtetutës, në Kosovë është themeluar banka qendrore e emërtuar Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, të cilës më tutje do ti referohemi si "Banka Qendrore". Banka Qendrore është pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

2. Sipas këtij ligji, Banka Qendrore është subjekt juridik publik bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe të dispozitave të këtij ligji, që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. Banka Qendrore nuk do të regjistrohet në regjistrin e bizneseve.

3. Banka Qendrore i ka të gjitha kompetencat e nevojshme për t'i arritur objektivat dhe për t'i zbatuar detyrat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 3 Kapaciteti ligjor

1. Banka Qendrore është subjekt juridik me kompetencë të plotë.

2. Banka Qendrore ka kompetenca të veçanta, të:

2.1. hyjë në marrëdhënie kontraktore;

2.2. ndërmarrë procedura ligjore dhe të jetë subjekt i këtyre procedurave; dhe

2.3. fitoi, administrojë, mbajë dhe disponoj pronë të luajtshme dhe të paluajtshme.

3. Banka Qendrore për aktivitetin e saj zyrtar i shfrytëzon dhe i administron tokën dhe objektet, duke e përfshirë pronën e tundshme dhe të patundshme, që gjendet në rrugën "Garibaldi", nr. 33, Prishtinë.

Neni 4 Lokacioni

1. Zyra qendrore e Bankës Qendrore është në Prishtinë.

2. Banka Qendrore mund të hapë zyra dhe objekte operimi në ato vende ku konsiderohet e nevojshme.

Neni 5 Kapitali

1. Kapitali i autorizuar i Bankës Qendrore, i regjistruar dhe i paguar tërësisht do të jetë një shumë ekuivalente me tridhjetë (30) milionë euro.
2. Fondi i kapitalit të autorizuar të Bankës Qendrore do të mbahet vetëm nga shteti dhe nuk do të jetë i transferueshëm apo subjekt detyrimi.
3. Kapitali i autorizuar i Bankës Qendrore mund të rritet për një shumë të propozuar nga Banka Qendrore dhe të aprovuar nga Qeveria. Asnjëherë nuk do të lejohet reduktimi i kapitalit të autorizuar.

Neni 6 Pavarësia dhe autonomia

Banka Qendrore, anëtarët e organeve vendimmarrëse ose personeli i Bankës Qendrore, nuk do të marrin udhëzime nga ndonjë person apo subjekt tjetër, duke përfshirë subjektet qeveritare. Pavarësia dhe autonomia e Bankës Qendrore respektohet në çdo kohë dhe asnjë person apo subjekt nuk do të provojë të ndikoj anëtarët e organeve vendimmarrëse apo të personelit të Bankës Qendrore në realizimin e detyrave të tyre apo të ndërhyjë në aktivitetet e Bankës Qendrore.

KREU III OBJEKTIVAT DHE DETYRAT

Neni 7 Objektivat

1. Objektiv parësor i Bankës Qendrore është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave.
2. Objektiv shtesë i Bankës Qendrore i cili i nënshtrohet objektivit parësor të saj, është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore.
3. Pa paragjykuar arritjen e këtyre objektivave, Banka Qendrore mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë.
4. Banka Qendrore vepron në pajtim me parimin e ekonomisë së tregu të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.

Neni 8 Detyrat

1. Detyrat e Bankës Qendrore në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në nenin 7 dhe në dispozitat e tjera të këtij ligji, përfshijnë:

1.1. përcaktimin dhe zbatimin e politikave të një sistemi financiar stabil duke përfshirë mbikëqyrjen e një skeme të sigurimit të depozitave, kryerjen e operacioneve të tregut, si dhe ofrimin e likuiditetit emergjent;

1.2. rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare ashtu si specifikohet më tej në këtë ligj apo ndonjë ligj tjetër;

- 1.3. promovimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë;
- 1.4. sigurimin e një furnizimi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave në Kosovë;
- 1.5. mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave ndërkombëtare;
- 1.6. mbledhjen dhe publikimin e statistikave;
- 1.7. kontribuon në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore;
- 1.8. informimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë dhe publikut të gjerë rreth politikave, detyrave dhe operacioneve të saj ashtu siç përcaktohet më tej në këtë ligj;
- 1.9. veprimin si bankier, këshilltar financiar dhe agjent fiskal për Qeverinë dhe çdo organ publik dhe organizatë publike të Kosovës;
- 1.10. bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në këshillat dhe organizatat ndërkombëtare përkitazi me çështje brenda fushës së saj të kompetencave; dhe
- 1.11. realizimin e çdo aktiviteti ndihmës që rrjedhë nga ushtrimi i detyrave të saj sipas këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër.

KREU IV OPERACIONET E BANKËS QENDRORE

Neni 9 Hapja e llogarive

1. Që t'i realizojë qëllimet e saj, Banka Qendrore mund të hapë dhe të mbajë në librat e saj llogari të parave dhe letrave me vlerë për:
 - 1.1. bankat dhe institucionet të tjera financiare, si dhe subjektet publike;
 - 1.2. bankat e huaja, bankat qendrore; institucionet financiare ndërkombëtare dhe sipas kërkesës qeveritë e huaja, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat donatore.
2. Pa i parajgykuar paragrafin 1 të këtij neni dhe paragrafin 1 të nenit 10 të këtij ligji, Banka Qendrore nuk do të hapë llogari në librat e saj për institucionet jo financiare apo personat fizikë.
3. Banka Qendrore përcakton kushtet për hapjen e llogarive në librat e saj.
4. Banka Qendrore mund të hapë dhe të mbajë llogari të parave të gatshme dhe letrave me vlerë në librat e:
 - 4.1. bankave dhe institucioneve financiare të tjera;
 - 4.2. bankave qendrore, bankave të huaja, institucioneve depozitare dhe organizatave ndërkombëtare.

Neni 10

Shërbimet e ruajtjes

1. Kundrejt pagesës së tarifave të arsyeshme, Banka Qendrore mund të ofrojë institucioneve financiare si dhe publikut të gjerë shërbime të ruajtjes për kartëmonedha dhe monedha, të denominuara në valutat që ajo përcakton, si dhe për letra me vlerë, metale të çmuara dhe asete të tjera me vlerë siç mund të përcaktohet nga Bordit ekzekutiv.
2. Bordi Ekzekutiv mund të përcaktojë kushtet për ofrimin e shërbimeve të ruajtjes.

Neni 11 Operacionet e tregut

1. Në mënyrë që të arrijë objektivat dhe të përmbushë detyrat e veta, Banka Qendrore mund të:
 - 1.1. veprojë në tregjet financiare me blerje dhe shitje të njëhershme, me çmim të tanishëm ose të ardhshëm apo nën marrëveshje riblerjeje, si dhe me huadhënie ose huamarrje të drejtave dhe të instrumenteve të tregtueshme, si dhe të metaleve të çmuara;
 - 1.2. kryej operacione kreditore me bankat dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut që veprojnë në Kosovë, me huadhënie të mbështetur me kolateral adekuat.
2. Bordi ekzekutiv, me urdhëresë, do të përcaktojë llojet e kolateraleve, instrumenteve dhe aktiviteteve për t'u përdorur për operacionet e Bankës Qendrore; si dhe do të deklarojë kushtet nën të cilat Banka Qendrore është e gatshme të marrë pjesë në transaksione të tilla.

Neni 12 Rezervat minimale

1. Banka Qendrore mund të kërkojë nga bankat në Kosovë të mbajnë rezerva minimale në llogari depozitash në Bankën Qendrore në përmbushje të objektivave të veta të caktuara në nenin 7 të këtij ligji. Me përjashtim të një veprimi të përkohshëm përmirësues të marr në përputhje me nenin 36 paragrafi I të këtij ligji, këto rezerva duhet të jenë të njëjta për të gjitha bankat për çdo kategori të detyrimeve për të cilat mund të paguhet normë e caktuar interesi.
2. Me propozimin e Bordit Ekzekutiv, Bordi i Bankës Qendrore miraton rregullore që përcakton kategoritë e detyrimeve të referuara në paragrafin 1 të nenit 12 si dhe të cakton metodën për llogaritjen dhe përcaktimin e rezervave minimale të kërkuara për t'u mbajtur sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe kompensimit të tyre.
3. Në rast të mos përmbushjes së kërkesave të nxjerra me rregullore sipas paragrafit paraprak, Bordi Ekzekutiv nxjerr urdhëresa dhe ka autoritet të shqiptoj interes ndëshkues ose të shqiptoj ndëshkime administrative, në pajtim me nenin 67, paragrafi 2 të këtij ligji, me efekt të krahasueshëm.

Neni 13 Instrumentet e kontrollit kreditor

Bordi Ekzekutiv, mund të vendosë për përdorimin e metodave operacionale të kontrollit kreditor ashtu siç e sheh të përshtatshme.

Neni 14 Mbështetja emergjente për likuiditet

1. Në rrethana të jashtëzakonshme, Banka Qendrore mundet, sipas gjykimit të saj dhe sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Bordi i Bankës Qendrore, të veprojë si kreditor i instancës së fundit për një bankë të licencuar. Një mbështetje e tillë mund të ofrohet duke i dhënë mbështetje financiare bankës, ose për përfitim të bankës, me norma të interesit të lidhura me gjobën që janë më të larta se norma aktuale e tregut, si rishikohet dhe përcaktohet periodikisht nga Bordi i Bankës Qendrore dhe për periudha kohore që nuk i tejkalojnë nëntëdhjetenjë (91) ditë kalendarike por që mund të ripërtërihen nga ana e Bordit të Bankës Qendrore, në bazë të një programi të miratuar nga Bordi Ekzekutiv që specifikon masat përmirësuese që banka përkatëse do t'i ndërmarrë, me kusht që, sidoqoftë, asnjë zotim i tillë nuk do të bëhet nga Bordi i Bankës Qendrore përveç nëse:

1.1. banka, sipas opinionit të Bordit Ekzekutiv, është solvente dhe mund të ofrojë kolateral të duhur për të mbuluar huan, si dhe kërkesa për asistencë financiare është bazuar në nevojën për të përmirësuar likuiditetin; ose

1.2. një mbështetje e tillë është e nevojshme për ta ruajtur stabilitetin e sistemit financiar.

2. Bordi Ekzekutiv do të përcaktojë vlerën maksimale kreditore të kolateralit të depozituar për të siguruar çdo operacion të kredisë të parashtruar në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Bordi Ekzekutiv ia propozon Bordit të Bankës Qendrore për miratim një rregullore të mbështetjes emergjente për likuiditetin.

4. Mbështetja emergjente e likuiditetit nuk mund të kalojë shumën totale të rezervave të BQK-së dhe Fondin Special të Rezervave të themeluar nga Thesari për këtë qëllim.

5. Nëse Banka Qendrore konstaton se banka e mbështetur nuk i ka zbatuar masat përmirësuese të specifikuara në paragrafin 1 të këtij neni, apo që këto masa nuk kanë sjellë rezultatet e synuara, Bordi Ekzekutiv do të ndërmarrë masat e duhura.

KREU V MENAXHIMI ME REZERVA NDËRKOMBËTARE

Neni 15 Menaxhimi me rezerva ndërkombëtare

1. Banka Qendrore realizon transaksione në rezervat ndërkombëtare dhe t'i menaxhojë këto rezerva në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare si dhe në varësi të objektivave të veta të përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, duke respektuar prioritetin e sigurisë, likuiditetit dhe të ardhurat.

2. Banka Qendrore mund të mbajë në portofolin e saj të rezervave ndërkombëtare ndonjë apo të gjitha asetet e mëposhtme:

2.1. ari dhe metalet e tjera të çmuara të mbajtur nga, ose për llogari të Bankës Qendrore, duke përfshirë bilancet kreditore që përfaqësojnë arin dhe metale të tjera të çmuara.

2.2. kartëmonedhat dhe monedhat e denominuara në valuta lehtë të konvertueshme të mbajtura nga ose për llogari të Bankës Qendrore;

2.3. bilancet kreditore dhe depozitat ndërbankare të cilat janë të pagueshme me kërkesë ose brenda një afati të shkurtër, që janë të denominuara në valuta lehtë të konvertueshme të mbajtura në llogari të Bankës Qendrore në librat e bankave të huaja, bankave qendrore apo institucioneve financiare ndërkombëtare;

2.4. letrat me vlerë të borxhit të tregtueshme lehtësisht dhe të denominuara në valuta lehtë të konvertueshme, që janë të emetuara nga, ose të mbështetura nga, garanci të plotë të qeverive të huaja, bankave qendrore të huaja apo institucioneve financiare ndërkombëtare;

- 2.5. kërkesat ndaj institucioneve financiare ndërkombëtare të cilat rezultojnë nga marrëveshjet e riblerjes, transaksionet e shitjes dhe të riblerjes si dhe marrëveshjet për huadhënie të letrave me vlerë përkitazi me letrat me vlerë të borxhit të referuara në nën-paragrafin 2.4. të këtij neni;
- 2.6. të Drejtat Speciale të Tërheqjes (SDR) të mbajtura në llogarinë e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar;
- 2.7. pozicioni rezervë i Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, si dhe organizata të tjera ndërkombëtare financiare të ngjashme;
- 2.8. çdo aset tjetër i tregtueshëm lehtësisht dhe i denominuar në valuta lehtë të konvertueshme siç përcaktohet nga Bordi ekzekutiv.
3. Në rast se rezervat ndërkombëtare zvogëlohen, ose sipas opinionit të Bankës Qendrore mund të zvogëlohen, ose arrijnë në nivele të cilat do të rrezikonin politikat e Bankës Qendrore, dhe Banka Qendrore nuk është në gjendje të korrigjojë këtë rënie, Banka Qendrore do t'i rekomandojë Ministrit një politikë për të dalë nga kjo situatë. Rekomandimi i Bankës Qendrore duhet të bazohet në një raport ku përfshihen shkaqet që sollën rënien në rezerva.

KREU VI VALUTA

Neni 16 Emetimi i valutës

1. Valuta e Kosovës do të përcaktohet me ligj në përputhje me nenin 11 të Kushtetutës.
2. Asnjë person juridik apo fizik përveç Bankës Qendrore nuk ka të drejtë të emetojë kartëmonedha dhe monedha.
3. Banka Qendrore do të jetë përgjegjëse për furnizimin e duhur me kartëmonedha dhe monedha në Kosovë.

Neni 17 Këmbimi i kartëmonedhave dhe monedhave të euros

Sipas kërkesës, Banka Qendrore do të këmbejë kartëmonedhat dhe monedhat e euros.

Neni 18 Kartëmonedhat dhe monedhat e euros të dëmtuara

1. Kartëmonedhat dhe monedhat e euros të dëmtuara që depozitohen në Bankën Qendrore nga institucionet financiare do të zëvendësohen nga Banka Qendrore me kartëmonedha ose monedha të euros.
2. Banka Qendrore mund të refuzojë të ndërrojë kartëmonedha ose monedha të tilla në rast se dizajnet e tyre janë të palexueshme, të deformuara, ose të shpuara, ose nëse mungon më shumë se dyzet përqind (40%) e sipërfaqes së tyre.
3. Bankës Qendrore nuk do t'i kërkohej të ofrojë asnjë kompensim për kartëmonedhat ose monedhat e humbura, të vjedhura apo të shkatërruara, dhe ajo mund të konfiskojë pa kompensim çdo kartëmonedhë të cilës i është ndryshuar pamja e saj e jashtme, duke përfshirë në veçanti

kartëmonedhat në të cilat është shkruar, vizatuar, shtypur, vulosur ose bërë ndonjë vrimë apo të cilave u është vënë materie ngjitëse.

Neni 19 Valuta false

1. Çdo person i cili për qëllime mashtrimi krijon, kopjon, imiton ose ndryshon ndonjë kartëmonedhë ose monedhë, a ndonjë çek, letër me vlerë ose kartë pagese; apo posedon, transporton ose vë në qarkullim ndonjë kartëmonedhë, monedhë, çek, letër me vlerë ose kartë pagese të tillë duke qenë në dijeni se është e krijuar, e kopjuar, e imituar ose e ndryshuar a e fabrikuar për qëllime mashtrimi; apo posedon ose transporton ndonjë pllakë, gur, letër, vegël ose objekt a substancë tjetër duke qenë në dijeni se është e destinuar për t'u përdorur në krijimin, kopjimin, imitimin ose ndryshimin për qëllime mashtrimi të ndonjë kartëmonedhe, monedhe, çeku, letre me vlerë ose karte pagese të tillë, do të jetë fajtor për vepër penale.

2. Kartëmonedhat dhe monedhat e paraqitura te institucionet financiare, që dyshohen të jenë false, qoftë të paraqitura në bankat dhe institucione financiare të regjistruara apo në subjekte të tjera të autorizuara për të realizuar këmbime valutore, duhet të nxirren nga qarkullimi dhe menjëherë t'u dërgohen autoriteteve të caktuara për këtë qëllim sipas rregulloreve të Bankës Qendrore dhe në përputhje me çdo dispozitë tjetër ligjore.

3. Bordi Ekzekutiv mund të nxjerrë urdhëresa për të zbatuar dispozitat e këtij neni.

4. Banka Qendrore do të mbaj të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat që i paraqiten asaj dhe që dyshohen të jenë imitime, kopje apo me ndryshime në vlerë, dhe menjëherë do të përgatisë një shkresë mbi identifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave, bartësin e tyre, si dhe arsyet e Bankës Qendrore për dyshim. Kjo shkresë do t'u dërgohet autoriteteve kompetente për zbatimin e ligjit për hetim dhe veprim të mëtejshme përkatës siç mund të kërkohet.

5. Banka Qendrore mund të kërkojë resurset e autoriteteve tjera për ndihmë në realizimin e qëllimeve të këtij neni.

Neni 20 Reprodukimi i valutës

1. Çdo reprodukim i kartëmonedhave dhe monedhave, si dhe krijimi i çdo objekti që nga dizajni imiton ndonjë kartëmonedhë apo monedhë, do të kërkojë autorizim paraprak me shkrim nga Banka Qendrore.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, Banka Qendrore mund të nxjerrë rregullore për autorizim të publikimit të reprodukimit të valutës.

3. Personi i cili shkel dispozitat e këtij neni mund t'i nënshtrohet gjobitjes siç përcaktohet në rregulloret e nxjerra nga Bordi i Bankës Qendrore.

KREU VII DETYRAT E SISTEMIT TË PAGESAVE

Neni 21 Shërbimet

1. Banka Qendrore mund të ofrojë shërbime, duke përfshirë kredi brenda-ditore të kolateralizuara me letra me vlerë të negociueshme të Qeverisë, për sisteme të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe për pjesëmarrësit në to, për të garantuar sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve të tilla.

2. Banka Qendrore është e autorizuar të organizojë, të posedojë, të marrë pjesë dhe të operojë sistemet e referuara në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 22 **Detyrat mbikëqyrëse**

1. Banka Qendrore është ekskluzivisht përgjegjëse për rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë ashtu siç specifikohet më tej me ligjet përkatëse. Një përgjegjësi e tillë do të përfshijë shqiptimin e ndëshkimeve administrative të parapara në nenin 67, paragrafi 2 të këtij ligji.

2. Bordi i Bankës Qendrore me miratimin e rregulloreve të parapara në nenin 65, paragrafi 2 të këtij ligji, mund që:

2.1. të kërkojë regjistrimin apo licencimin e çdo sistemi të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, apo operatori të sistemit të tillë;

2.2. të kërkojë nga çdo sistem të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë apo operator i sistemit të tillë që të respektohen kushtet dhe kërkesat siç mund të caktohen nga Bordi Ekzekutiv; dhe

2.3. të rregullojë dhe të mbikëqyrë vënien në qarkullim dhe cilësinë e instrumenteve të pagesave.

3. Personeli i Bankës Qendrore, dhe çdo person tjetër i kualifikuar i caktuar nga Bordi Ekzekutiv, mund të vizitojë zyrat e sistemeve të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe të pjesëmarrësve të tyre, për të kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe evidencat e tjera, për të marrë informacione dhe evidenca nga to, si dhe për të marrë çdo masë tjetër që do të konsiderohet e nevojshme apo e këshillueshme nga Banka Qendrore.

4. Sistemet e pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë, si dhe pjesëmarrësit e tyre do t'i sigurojnë Bankës Qendrore informacione dhe evidenca siç mund të kërkojë Banka Qendrore.

5. Banka Qendrore mund të shpalosë informacionin dhe të dhënat e pranuar sipas paragrafit 4. të këtij neni tërësisht ose pjesërisht në formë të agreguar, apo në përputhje me nenin 74, paragrafi 2 të këtij ligji.

KREU VIII **MBIKËQYRJA E INSTITUCIONEVE FINANCIARE**

Neni 23 **Detyrat e mbikëqyrjes**

1. Banka Qendrore është ekskluzivisht përgjegjëse për licencimin, regjistrimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare ashtu siç përcaktohet me ligjet përkatëse. Një përgjegjësi e tillë përfshin shqiptimin e ndëshkimeve administrative të parapara me nenin 67 paragrafi 2 të këtij ligji.

2. Personeli i Bankës Qendrore, dhe çdo person tjetër i kualifikuar i caktuar nga Bordi Ekzekutiv, viziton zyrat e institucioneve financiare për të kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe evidencat e tjera, për të marrë informacione dhe evidenca nga to si dhe për të marrë çdo veprim tjetër konsiderohet e nevojshme apo e këshillueshme nga Banka Qendrore.

3. Institucionet financiare do t'i sigurojnë Bankës Qendrore informacione dhe evidenca lidhur me veprimtarinë e tyre si dhe gjendjen financiare, siç mund të kërkojë Banka Qendrore.

4. Banka Qendrore mund të shpalojë informacionin dhe të dhënat e pranuar sipas paragrafit 3. të këtij neni tërësisht ose pjesërisht në formë të agreguar për klasat e institucioneve financiare të përcaktuara në përputhje me natyrën e biznesit të tyre, apo në përputhje me nenin 74, paragrafi 2 të këtij ligji.

KREU IX SISTEMI I INFORMACIONIT TË KREDIVE

Neni 24 Sistemi i informacionit të kredive

1. Banka Qendrore mund të operojë, të rregullojë, të licencojë, të regjistrojë dhe të mbikëqyrë sistemet e informacionit të kredive me qëllim të mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit të kredive mes institucioneve financiare si dhe mund të nxjerrë rregullore për zbatimin përkatës.

2. Informacioni i mbledhur dhe i mbajtur në sistemet e informacionit të kredive të referuara në paragrafin 1. të këtij neni do të përdoret vetëm për qëllime të përmirësimit të cilësisë së kredive bankare si dhe të mbikëqyrjes së institucioneve financiare nga Banka Qendrore.

KREU X STATISTIKAT DHE INFORMACIONI

Neni 25 Mbledhja e statistikave dhe informacionit

1. Banka Qendrore, në përmbushje të objektivave të përcaktuara në nenin 7 dhe ashtu si përshkruhen më tej në këtë ligj do të:

1.1. mbledhë, përpilojë, analizojë, përmbledhë dhe publikojë statistika dhe informacione të nevojshme për realizimin e detyrave të veta;

1.2. Bordi i bankës Qendrore do të përkufizojë, me anë të rregulloreve, informacionin statistikor të kërkuar si dhe formën në të cilën ky informacion do t'i sigurohet Bankës Qendrore, personat fizikë dhe juridikë që iu nënshtrohen kërkesave të raportimit, regjimin e aplikuar të konfidencialitetit si dhe ndëshkimet administrative, në përputhje me nenin 67, paragrafi 2 të këtij ligji, që mund t'u shqiptohen personave fizikë dhe juridikë që veprojnë në shkelje të këtyre kërkesave statistikore;

1.3. bashkëpunojë me ministritë dhe agjencitë qeveritare në mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave dhe informacioneve të tjera relevante;

1.4. koordinojë me agjenci bilaterale dhe multilaterale adaptimin e standardeve ndërkombëtare të shpërndarjes së të dhënave me qëllim të arritjes së konsistencës dhe efikasitetit në organizimin e statistikave dhe informacionit.

Neni 26 Sigurimi i statistikave dhe informacionit

Personat fizikë dhe juridik prej të cilëve kërkohet që të ofrojnë të dhëna statistikore ashtu siç përkufizohen në rregulloret e përmendura në nenin 25 të këtij ligji obligohen t'ia sigurojnë Bankës Qendrore informacionin e kërkuar.

Neni 27 **Shpërndarja e statistikave dhe informacionit**

1. Banka Qendrore do të shpalojë:

1.1. statistikave dhe informacionet në varësi të rregulloreve mbi regjimin e konfidencialitetit ashtu siç përmendet në nenin 25 të këtij ligji;

1.2. dokumentacionin mbi metodologjinë e aplikuar për përpilim; dhe

1.3. të dhënat dhe konceptet statistikore relevante që do të lejojnë verifikimin e jashtëm të statistikave të publikuara nga Banka Qendrore.

Neni 28 **Publikime të tjera**

1. Të paktën një herë në vit, si dhe varësisht prej nevojës edhe më shpesh, Banka Qendrore do të informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe publikun në lidhje me realizimin e politikave të saj, arritjet e objektivave të saj, si dhe këndvështrimet e saj në lidhje me treguesit real të ekonomisë.

2. Brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit financiar, Banka Qendrore do t'i dorëzojë zyrtarisht Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë si dhe do të publikoj një apo më shumë raporte të aprovuara nga Bordi i Bankës Qendrore mbi gjendjen e ekonomisë gjatë vitit financiar të porsapërfunduar, duke përfshirë një parashikim mbi ekonominë e vitit në vijim, arritjen e objektivave të politikave të saj dhe gjendjen e sistemit financiar të Kosovës. Raporti duhet gjithashtu të përmbajë një rishikim dhe vlerësim të politikave të Bankës Qendrore të ndjekura gjatë vitit financiar të kaluar, si dhe një përshkrim dhe shpjegim të politikave për t'u ndjekur gjatë vitit financiar në vijim.

KREU XI **MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, QEVERINË DHE SHPETITIN**

Neni 29 **Përgjegjësia para Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Duke e përfillur si duhet nenin 6 të këtij ligji, guvernatori me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës ose me nismën e vet, së paku një herë në vit, dëgjohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe nga komisionet e tij për objektivat e Bankës Qendrore të parashtruar në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 30 **Bankier, këshilltar financiar dhe agjent fiskal për Qeverinë**

1. Banka Qendrore vepron si bankier dhe si këshilltar financiar për Qeverinë.

2. Banka Qendrore mund, për dhe në emër të Qeverisë, të pranojë huazime të jashtme, të menaxhojë dhe të administrojë borxhe të tilla, si dhe të shlyejë të drejtat dhe detyrimet financiare të Shtetit ndaj palëve të jashtme.

3. Banka Qendrore mund, sipas kushteve për të cilat do të merret vesh me Qeverinë, të veprojë si agjent fiskal për llogari të Qeverisë ose për agjenci tjetër publike të përcaktuar nga Qeveria.
4. Banka Qendrore mund të operojë me regjistër të letrave me vlerë të emetuara nga Shteti.

Neni 31 **Depozitar dhe arkëtar për Qeverinë**

1. Banka Qendrore merr depozita në çdo valutë prej Qeverisë, ose në emër të saj, ose prej çdo agjencie tjetër publike. Si depozitar, Banka Qendrore merr dhe paguan fondet, mban llogari për to, si dhe ofron shërbime të tjera financiare për to.
2. Banka Qendrore do të paguajë deri te limitet e shumave të depozituara kundrejt urdhërpagesave në lidhje me llogaritë përkatëse.
3. Banka Qendrore mund të paguajë interes në depozitat e tilla deri në normat e tregut.

Neni 32 **Bashkëpunimi me institucionet qendrore të shtetit**

1. Duke ndjekur në mënyrë të duhur nenin 6 të këtij ligji, si dhe në përmbushje të objektivave dhe detyrave të veta të përcaktuar nga neni 7, paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, Banka Qendrore do të:
 - 1.1. bashkëpunojë me Qeverinë dhe çdo subjekt tjetër publik; dhe
 - 1.2. mbajë mbledhje të rregullta me Ministrinë për çështje të interesit të përbashkët.
2. Banka Qendrore dhe Ministria do të informojnë njëra-tjetrën plotësisht për të gjitha çështjet që prekin bashkërisht Bankën Qendrore dhe Ministrinë.
3. Banka Qendrore mund t'i ofrojë këshilla Qeverisë për çdo çështje e cila në opinionin e saj ka mundësi të ndikojë në përmbushjen e objektivave të Bankës Qendrore.
4. Me kërkesë të Qeverisë, Banka Qendrore do t'i ofrojë asaj informacione në lidhje me detyrat e veta; informacione specifike në lidhje me subjektet e mbikëqyrura mund të ofrohen me kufizime për të ruajtur konfidencialitetin ashtu si Banka Qendrore i konsideron të duhura.
5. Me kërkesë të Qeverisë, Banka Qendrore do t'i ofrojë Qeverisë të dhënat përkatëse në lidhje me pranimin e fondeve nga ana e Bankës Qendrore prej çdo burimi.
6. Me kërkesë të Bankës Qendrore, Qeveria do t'i ofrojë Bankës Qendrore informacione dhe dokumente që mund të kërkohen nga ana e Bankës Qendrore për qëllim të realizimit të detyrave të saj.
7. Banka Qendrore do të konsultohet nga Qeveria për çdo projektligj që ka të bëjë me çështjet që lidhen me objektivat e Bankës Qendrore ose që janë brenda fushave të kompetencës së saj, para se këto ligje t'i dorëzohen Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qeveria bashkë me projektligjin do të dorëzojë në Kuvend të Republikës së Kosovës edhe këndvështrimet e Bankës Qendrore.
8. Kërkesat që dalin nga dispozitat e këtij neni do të përmbushen në afatin e përcaktuar kohor.

Neni 33 **Ndalimi i kreditimit të Qeverisë**

1. Banka Qendrore nuk do të lejojë asnjë kredi direkte apo indirekte për Qeverinë apo ndonjë agjenci tjetër publike ose subjekt tjetër në pronësi të Shtetit, me përjashtim të kredive brenda-ditore për të siguruar funksionimin e rregullt të sistemit të pagesave. Kreditë e tilla brenda-ditore do të jenë të kolateralizuara me letra me vlerë të tregtueshme të Qeverisë dhe do të kthehen tërësisht para fundit të së njëjtës ditë.

2. Kufizimet e paragrafit 1. të këtij neni në lidhje me ofrimin e kredive direkte apo indirekte për Qeverinë, nuk do të aplikohen ndaj bankave në pronësi publike, të cilat do të trajtohen njësoj si bankat në pronësi private.

3. Banka Qendrore mund të blejë letra me vlerë të tregtueshme të Qeverisë me kusht që këto blerje të bëhen vetëm në tregun sekondar.

KREU XII QEVERISJA DHE ORGANIZIMI

PJESA 1 ORGANET VENDIMMARRËSE

Neni 34

Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori

1. Organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore do të jenë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori.

2. Bordi i Bankës Qendrore do të përbëhet nga Guvernatori, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në përputhje me nenin 79, paragrafi 2 të këtij ligji dhe tre (3) anëtarë joekzekutivë, të cilët do të ngarkohen me detyrën e aprovimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të politikave si dhe mbikëqyrjen e administrativit dhe të aktiviteteve të Bankës Qendrore. Anëtarët jo-ekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore nuk do të jenë anëtarë të personelit të Bankës Qendrore.

3. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga guvernatori, i cili do të jetë kryesues, si dhe nga zëvendësguvernatorët dhe do të jetë i ngarkuar me zbatimin e politikave të Bankës Qendrore dhe të operacioneve të saj. Për numrin e zëvendësguvernatorëve vendos Bordi i Bankës Qendrore, në bazë të propozimit të guvernatorit.

4. Guvernatori do të shërbejë si kryeshef ekzekutiv i Bankës Qendrore i ngarkuar me operacionet e përditshme të Bankës Qendrore. Zëvendësguvernatorët do të ndihmojnë Guvernatorin në realizimin e operacioneve të përditshme të Bankës Qendrore.

Neni 35

Kompetencat dhe detyrat e Bordit të Bankës Qendrore

1. Bazuar në nenin 7, nenin 8, nenin 34 të këtij ligji si dhe në cilindo nen tjetër të këtij Ligji, Bordi i Bankës Qendrore ka kompetencat dhe detyrat në vijim:

1.1. miraton të gjitha rregulloret e Bankës Qendrore dhe të mbikëqyrë zbatimin e politikave si dhe përmbushjen e detyrave të Bankës Qendrore;

1.2. miraton rregulloren në lidhje me masat emergjente të likuiditetit, të propozuar nga Bordi Ekzekutiv sipas nenit 36, 1.8 të këtij ligji;

1.3. miraton emërimin e Shefit të Auditimit të Brendshëm me rekomandim të Guvernatorit;

- 1.4. emëron zëvendësguvernatorët me propozim të Guvernatorit;
- 1.5. emëron Sekretarin e Bordit të Bankës Qendrore me propozim të Guvernatorit;
- 1.6. miraton buxhetin vjetor të Bankës Qendrore i cili në mënyrë specifike duhet gjithashtu të përfshijë miratimin e një plani të kompensimit vjetor për të gjithë punonjësit;
- 1.7. përcakton politikat kontabël të Bankës Qendrore dhe të aprovojë raportin vjetor si dhe raporte të tjera dhe deklarata financiare të Bankës Qendrore;
- 1.8. emëron Auditorin e Jashtëm të Bankës Qendrore;
- 1.9. vendos nëse Banka Qendrore duhet të marrë hua dhe i përcakton kushtet për hua të tilla;
- 1.10. sipas rekomandimit të Bordit Ekzekutiv, përcakton strukturën organizative të Bankës Qendrore, përfshirë themelimin dhe lokacionin e zyrave dhe objekteve të operimit;
- 1.11. miraton rregullat për procedurat e Bordit të Bankës Qendrore; dhe
- 1.12. ushtron detyra dhe kompetenca të tilla të cilat i jepen nga ky ligj apo ndonjë ligj tjetër.

Neni 36 **Kompetencat dhe detyrat e Bordit Ekzekutiv**

1. Bazuar në nenin 7, në nenin 8, në nenin 34, si dhe në çdo nen tjetër të këtij ligji, Bordi Ekzekutiv do t'i ketë kompetencat dhe detyrat e caktuara në vijim:

- 1.1. t'i përcaktojë dhe t'i miratojë politikat e Bankës Qendrore për ta nxitur dhe për ta mbajtur stabil sistemin financiar, si dhe një sistem të sigurt, të shëndoshë dhe efikas të pagesave;
- 1.2. t'i përcaktojë dhe t'i miratojë politikat e Bankës Qendrore për të kontribuar në arritjen dhe në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore;
- 1.3. të përcaktojë dhe të miratojë politika të tjera të Bankës Qendrore, që kanë të bëjnë me zbatimin e detyrave të saj, si dhe të miratojë sipas nevojës rregulla të brendshme për zbatimin e tyre;
- 1.4. t'i përcaktojë politikat e përgjithshme dhe t'i miratojë statutin dhe rregullat brendshme të zbatueshme për administrimin dhe veprimtarinë e Bankës Qendrore;
- 1.5. t'i rekomandojë Bordit të Bankës Qendrore ta përcaktojë strukturën organizative të Bankës Qendrore, duke i përfshirë themelimin dhe lokacionin e zyrave dhe të objekteve të operimit;
- 1.6. t'i miratojë emërimet e drejtorëve të departamenteve dhe të divizioneve;
- 1.7. t'i ushtrojë pushtetin dhe detyrat e Bankës Qendrore të përcaktuara në nenet 12, 15, paragrafi 3, në nenin 19, paragrafi 3, në nenet 22 dhe 30, paragrafi 3, të këtij ligji;
- 1.8. t'i përcaktojë kategoritë e aseteve, që do t'i përbëjnë rezervat ndërkombëtare;
- 1.9. t'i përcaktojë kategoritë e aseteve të përshtatshme për investime të resurseve financiare të Bankës Qendrore;
- 1.10. ta miratojë ose ta refuzojë dhënien e licencave dhe të lejeve për sistemet e pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë dhe t'i revokojë këto licenca dhe leje;

1.11. ta miratojë ose ta refuzojë dhënien e licencave ose të lejeve për institucionet financiare, si dhe t'i revokojë këto licenca dhe leje;

1.12. të ndërmarrë masa detyruese, duke e përfshirë udhëzimin e çdo banke të mbikëqyrur ose të institucioneve financiare dhe të çdo sistemi të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së letrave me vlerë; të ndërmarrë veprime përmirësimi, ose duke e emëruar një likuidator për entitete të tilla, ose duke shqiptuar gjoha administrative, ashtu siç i përcakton ky ligj ose ndonjë ligj tjetër dhe pastaj t'i raportojë Bordit të Bankës Qendrore për çdo veprim të tillë;

1.13. të themelojë një ose më shumë organe këshilluese, t'i përcaktojë rregullat dhe kushtet për emërimin e anëtarëve të tyre, si dhe t'i përcaktojë termat e referencës për organe të tilla;

1.14. t'i vlerësojë rreziqet dhe të hartojë plane, që në rast të papriturash në të ardhmen, të sigurohen vazhdimësia e veprimtarive dhe siguria e Bankës Qendrore;

1.15. t'i propozojë Bordit të Bankës Qendrore rregullore për mbështetjen emergjente të likuiditetit;

1.16. t'i miratojë rregullat e procedurave për Bordin Ekzekutiv; dhe

1.17. detyrat dhe kompetencat e tilla të tjera, që përcaktohen qartë me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër.

Neni 37

Kompetencat dhe detyrat e Guvernatorit

1. Guvernatori propozon dhe zbaton politikat e Bankës Qendrore për të realizuar objektivat e parashtruara në nenin 7 të këtij ligji. Guvernatori mund të delegojë, me shkrim, secilën nga kompetencat apo detyrat e tij/saj tek njëri prej Zëvendësguvernatorëve apo tek anëtarë të tjerë të lartë të personelit.

2. Guvernatori do të përcakton renditjen me të cilën Zëvendësguvernatorët do ta zëvendësojnë atë gjatë çdo periudhe të mungesës apo paaftësisë së tij/saj për punë.

3. Guvernatori është përgjegjës ndaj Bordit të Bankës Qendrore për ekzekutimin e politikave të Bankës Qendrore si dhe për drejtimin dhe kontrollin e administrimit dhe operacioneve të Bankës Qendrore.

4. Të gjitha kompetencat, sipas këtij ligji, që nuk janë rezervuar në mënyrë specifike për Bordin e Bankës Qendrore ose për Bordin Ekzekutiv, do t'i ngarkohen guvernatorit. Brenda kufizimeve të kompetencave të tij, guvernatori do të ketë autoritet t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për administrimin ose për operacionet e Bankës Qendrore, duke i përfshirë pa kufizime prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve, realizimin e zotimeve kontraktuese në emër të Bankës Qendrore, emërimin e anëtarëve të personelit dhe të agjentëve të Bankës Qendrore, si dhe përfaqësimin e përgjithshëm të Bankës Qendrore, duke e përfshirë përfaqësimin para organeve të drejtësisë.

5. Guvernatori i raporton Bordit të Bankës Qendrore jo më pak se dhjetë herë në vit mbi realizimin e operacioneve dhe politikave të Bankës Qendrore, mbi qëndrueshmërinë e sistemit financiar, si dhe mbi gjendjen e tregjeve të parasë, të kapitalit dhe të valutave, duke përfshirë të gjitha ngjarjet dhe kushtet që kanë ose pritet të kenë ndikim domethënës në administrimin apo operacionet e Bankës Qendrore, në realizimin e politikave të saj, në sistemin financiar, apo në tregjet e përmendura më lart.

Neni 38

Emërimet

1. Guvernatori dhe anëtarët jo-ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore emërohen për një mandat prej pesë (5) vitesh. Këto mandate do të mbesin të shkallëzuara. Asnjë anëtar i Bordit të Bankës Qendrore apo i Bordit Ekzekutiv nuk do të shërbejë për më shumë se dhjetë (10) vjet në këto Bode përkatëse; përveç në rast se një zëvendës guvernator emërohet si Guvernator, atëherë ai person do të ketë të drejtë për të shërbyer dy (2) mandate nga pesë (5) vjet si Guvernator.

2. Kurdo që paraqitet boshllëku i Guvernatorit apo i ndonjërit nga anëtarët jo ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore, do të konstituohet një panel i përbërë nga anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës Qendrore dhe Guvernatori, ku asnjëri prej tyre nuk kërkon riemërim. Ky panel do të publikojë një njoftim në gazetë që kanë një qarkullim të përgjithshëm në Kosovë për një periudhë prej së paku dy (2) javësh. Pas kësaj paneli do të shqyrtojë të gjitha kërkesat dhe rezymetë. Paneli do t'i përzgjedh të gjithë aplikantët në baze të kualifikimeve dhe performancave gjatë intervistimit dhe do të jap shpjegim me shkrim për një përzgjedhje të tillë. Lista me radhitjen e të gjithë aplikantëve që konsiderohen nga paneli se kanë përmbushur kriteret do të dërgohet në Kuvend të Republikës së Kosovës dhe Qeveri, e cila mund t'i jap një mendim Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kusht që ky mendim të dërgohet në Kuvend të Republikës së Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Nga ajo listë, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të përzgjedhë një individ për secilën pozitë në Bordin e Bankës Qendrore që duhet të plotësohet. Pasi që Kuvendi i Republikës së Kosovës të ketë bërë përzgjedhjen e fundit do t'ia përcjellë presidentit këto propozime, i cili pastaj do të miratojë dhe do të emërojë një person për të plotësuar pozitën e lirë.

3. Zëvendësguvernatorët do të emërohen nga Bordin i Bankës Qendrore me propozim të Guvernatorit.

4. Përzgjedhja, nominimi dhe emërimi i anëtarëve të organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore do të jetë transparent dhe në përputhje me nenin 40 dhe nenin 41 të këtij ligji.

5. Përbërja e organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore do të reflektojë fushat e ekspertizës të referuara në nenin 40 paragrafi 1. të këtij ligji.

6. Procedurat e emërimit të referuara në paragrafët 1 deri 5 të këtij neni përfundojnë brenda dyzetepesë (45) ditëve kalendarike para përfundimit të mandatit të anëtarit përkatës të Bordit të Bankës Qendrore apo Bordit Ekzekutiv.

Neni 39 Kompensimi

1. Kompensimi i anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore dhe Bordit Ekzekutiv duhet të përmbushë interesat e Bankës Qendrore dhe duhet të jetë e tillë që të rekrutohen dhe të mbahen ekspertët dhe zyrtarët e kualifikuar.

2. Kompensimi total vjetor për anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore dhe ata të Bordit Ekzekutiv duhet të aprovohet si pjesë e buxhetit të Bankës Qendrore, siç përcaktohet me nenin 35 paragraf 1 nën-paragrafi 1.6. i këtij ligji dhe të shpalojë në raport siç i referohet neni 59 të këtij ligji.

3. Asnjë s Kompensimi i paguar në Bankën Qendrore nuk mund të bazohet në fitimet e Bankës apo të ardhurave të tjera. Çdo pagesë apo kompensim përveç asaj që përmendëm në paragrafin 2. të këtij neni duhet të shpalojë në raportin të cilit i referohet neni 59, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2 të këtij ligji.

Neni 40 E drejta për t'u zgjedhur

1. Personat që kualifikohen për t'u zgjedhur që të shërbejnë në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore duhet të jenë me integritet dhe të kenë diplomë universitare si dhe të kenë të paktën dhjetë (10) vjet përvojë profesionale apo akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike.

2. Asnjë person nuk do të kualifikohet për t'u zgjedhur që të shërbejë në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore nëse ai/ajo:

2.1. ka qenë i dënuar për shkelje ligji që mbart një dënim, si vepër penale, përjashtimisht në kundërvajtje.

2.2. ka qenë debitor në një procedurë të falimentimit apo josolvensës.

2.3. për arsye të sjelljes personale jo të mirë, ka qenë diskualifikuar apo suspenduar nga një autoritet kompetent për ushtrimin e profesionit ose nuk ka qenë lejuar të jetë drejtor apo zyrtar i një institucioni financiar.

3. Asnjë person nuk do të shërbejë në organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore përderisa është anëtar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i Qeverisë, zyrtar i një ministrie të Qeverisë ose i ndonjë entiteti publik tjetër, ose zyrtar a punëtor i një institucioni financiar, i cili vepron me zyrtarët e tij në Kosovë, ose është pronar i drejtpërdrejtë ose pronar aktual i pesë për qind (5%) të shumës së interesit të ekuitetit në një institucion financiar të tillë.

4. Përjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni një zyrtar apo punëtor i një universiteti apo ndonjë organizate apo institucioni që ka pavarësi operationale nga Qeveria nuk do të konsiderohet të jetë zyrtar apo punëtor i Qeverisë apo i një ministrie të Qeverisë.

Neni 41

Diskualifikimi dhe shkarkimi nga Bordi i Bankës Qendrore

1. Guvernatori apo çdo anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore, do të shkarkohet prej postit nga Presidenti, bazuar në rekomandimin e shumicës së anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore dhe pas votimit të shumicës në Kuvend të Republikës së Kosovës kur këta anëtarë të Bordit të Bankës Qendrore dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës vijnë në përfundim se cilado nga arsyet e dhëna në nenin 40, paragrafët 1,2 dhe 3 të këtij ligji aplikohet ndaj anëtarit në fjalë të Bordit të Bankës Qendrore.

2. Përveç dispozitave në paragrafin 1. të këtij neni, Guvernatori apo çdo anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore mund të shkarkohet prej postit nga Presidenti, bazuar në rekomandimin e shumicës së anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore dhe votimit të shumicës në Kuvend të Republikës së Kosovës, kur këta anëtarë të Bordit të Bankës Qendrore dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës dalin në përfundim se anëtari në fjalë i Bordit të Bankës Qendrore:

2.1. nuk është në gjendje të përmbushë funksionet e atij posti për shkak të një sëmundjeje trupore apo mendore që ka zgjatur për më shumë se tre (3) muaj; ose

2.2. ka dështuar në realizimin e detyrave të tij/saj për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muajve pa aprovim nga Bordi i Bankës Qendrore; ose

2.3. ka marrë pjesë aktive në aktivitete politike pasi që është emëruar si anëtar i Bordit të Bankës Qendrore .

3. Nëse Presidenti apo shumica e thjesht e anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se Bordi i Bankës Qendrore ka dështuar të veprojë sipas kërkesave në bazë të arsyeve të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, Presidenti apo Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht, do të emërojë një panel të përbërë nga një (1) kryesues i cili mban apo ka mbajtur post të lartë gjyqësor, dhe jo më pak se dy (2) persona të tjerë, njëri prej të cilëve do të ketë ekspertizë në punët bankare apo financiare, të cilët do të hetojnë mbi çështjen dhe do t'i raportojnë Presidentit dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës me një rekomandim. Më pas, Kuvendi i Republikës së Kosovës me shumicë të thjesht votash do të vendos mbi çështjen në përputhje me paragrafin 1. apo 2. të këtij neni dhe do të dërgoj propozimin për shkarkim tek

Presidenti. Presidenti mund ta aprovoj ose mos ta aprovoj propozimin e Kuvendit për shkarkim të Guvernatorit apo cilit do anëtar të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës.

4. Asnjë anëtar i Bordit të Bankës Qendrore nuk mund të shkarkohet prej postit për arsye të tjera nga ato të përcaktuara në paragrafët 1. 2. dhe 3. të këtij neni.

Neni 42 **Diskualifikimi dhe shkarkimi nga Bordi Ekzekutiv**

1. Bordi i Bankës Qendrore do të shkarkojë prej postit një Zëvendësguvernator, bazuar në rekomandimin e Guvernatorit, kur ai/ajo del në përfundim se cilado nga arsyet e dhëna në nenin 40 paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij ligji, aplikohet ndaj Zëvendësguvernatorit në fjalë.

2. Përveç dispozitave të përshkruara në paragrafin 1. të këtij neni, Zëvendësguvernatori mund të shkarkohet prej postit nga Bordi i Bankës Qendrore, bazuar në rekomandimin nga Guvernatori, kur ai/ajo del në përfundim se Zëvendësguvernatori në fjalë:

2.1. nuk është në gjendje të përmbushë funksionet e atij posti për shkak të një sëmundjeje trupore apo mendore që ka zgjatur për më shumë se tre (3) muaj; ose

2.2. ka dështuar në realizimin e detyrave të tij ose të saj për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muajve pa aprovim nga Bordi Ekzekutiv; ose

2.3. ka marrë pjesë aktive në aktivitete politike pasi që është emëruar si anëtar i Bordit Ekzekutiv.

3. Nëse Bordi i Bankës Qendrore ka arsye të mjaftueshme të besojë se Guvernatori ka dështuar të veprojë sipas kërkesave në bazë të arsyeve të referuara në paragrafin 1. ose paragrafin 2. të këtij neni, Bordi i Bankës Qendrore do të emërojë një panel të përbërë nga një kryesues i cili mban apo ka mbajtur post të lartë gjyqësor, dhe jo më pak se dy (2) persona të tjerë, njëri prej të cilëve do të ketë ekspertizë në punët bankare apo financiare, të cilët do të hetojnë mbi çështjen dhe do t'i raportojnë Bordit të Bankës Qendrore me një rekomandim. Më pas, Bordi i Bankës Qendrore do të vendosë mbi çështjen në përputhje me paragrafin 1. apo paragrafin 2. të këtij neni.

4. Asnjë zëvendësguvernator nuk mund të shkarkohet prej postit për arsye të tjera nga ato të përcaktuara në paragrafët paraprakë të këtij neni.

5. Zëvendësguvernatori i cili shkarkohet prej postit ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Supreme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike nga data e vendimit.

Neni 43 **Dorëheqja**

1. Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët mund të japin dorëheqje duke njoftuar me shkrim Presidentin ose Bordin e Bankës Qendrore, përkatësisht, të paktën tre (3) muaj përpara.

2. Anëtarët joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore mund të japin dorëheqje duke njoftuar me shkrim Presidentin dhe Bordin e Bankës Qendrore të paktën dy (2) muaj përpara.

Neni 44 **Kufizimet në funksionet pasuese**

1. Ish-anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore apo të Bordit Ekzekutiv nuk do të shërbejnë në asnjë lloj cilësie në një bankë apo institucion financiar tjetër në Kosovë për një periudhë një (1) viti pas largimit nga Banka Qendrore.

2. Gjatë periudhës së kufizimit të përcaktuar në paragrafin përcaktuar 1. të këtij neni, Bordi i Bankës Qendrore mund të përcaktojë një nivel të duhur kompensimi për t'u paguar ndaj këtyre ish-anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore dhe Bordit Ekzekutiv.

Neni 45 **Postet e lira**

Çdo post i lirë në Bordin e Bankës Qendrore apo Bordin Ekzekutiv do të plotësohet brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike me emërimin e një anëtari të ri të Bordit të Bankës Qendrore apo të Bordit Ekzekutiv, për të plotësuar mandatin e mbetur të anëtarit të mëparshëm.

Neni 46 **Mungesa apo pamundësia relativisht afatgjate për të vepruar e Bordit Ekzekutiv**

1. Në rast rrethanash të jashtëzakonshme dhe nëse të gjithë anëtarët e Bordit Ekzekutiv mungojnë apo nuk janë në gjendje të veprojnë, posti i Guvernatorit do të merret përkohësisht nga Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore. Dy (2) anëtarët joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore që janë më së gjati në post të tillë si dhe në dispozicion do të marrin përkohësisht postet e Zëvendësguvernatorëve.

2. Në rast se mungesa ose paaftësia për të vepruar e të gjithë anëtarëve të Bordit Ekzekutiv vazhdon për një periudhë prej tre (3) muaj, duhet të krijohen vendet e lira dhe do të zbatohen procedurat për emërim sipas nenit 38 të këtij ligji.

PJESA 2 **MBLEDHJE DHE PROCEDIMET E BORDIT TË BANKËS QENDRORE**

Neni 47 **Mbledhjet**

1. Mbledhjet e Bordit të Bankës Qendrore do të kryesohen nga Kryetari, i cili do të zgjidhet prej Bordit të Bankës Qendrore nga radhët e anëtarëve joekzekutivë të tij. Në mungesë të Kryetarit, mbledhjet do të kryesohen nga anëtari joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore që është më së gjati në post të tillë.

2. Bordi i Bankës Qendrore do të mbledhet aq shpesh sa do të kërkohet nga veprimtaria e Bankës Qendrore por jo më pak se dhjetë (10) herë për vit kalendarik.

3. Mbledhjet e Bordit të Bankës Qendrore do të thirren nga Kryetari apo Guvernatori dhe gjithashtu mund të thirren me kërkesë me shkrim të cilido nga dy (2) anëtarë të tjerë të Bordit të Bankës Qendrore.

4. Mbledhjet e Bordit të Bankës Qendrore do të thirren duke komunikuar kohën, vendin si dhe agjendën e mbledhjes të të gjithë anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore ashtu si përcaktohet në rregullat e punës së Bordit të Bankës Qendrore.

5. Kuorumi për punë në çdo mbledhje të Bordit të Bankës Qendrore do të përbëhet nga të paktën tri të pestat (3/5) e anëtarëve të Bordit, njëri prej të cilëve është Guvernatori.

6. Nëse kuorumi mungon, Kryetari, apo në mungesë të tij/saj, anëtari joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore që është më së gjati në post të tillë, mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme në të cilën mund të merren vendime pa marrë parasysh ekzistimin e kuorumit; vendimet e tilla duhet të ratifikohen në mbledhjen e rregullt të radhës së Bordit të Bankës Qendrore në mënyrë që të mbesin në fuqi.

7. Çdo anëtar i Bordit të Bankës Qendrore do të ketë një (1) votë dhe në rast votash të barabarta, vota e personit që kryeson mbledhjen e përcakton rezultatin e votimit.
8. Përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj, vendimet e Bordit të Bankës Qendrore do të miratohen me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
9. Zëvendësguvernatorët mund të jenë të pranishëm në mbledhjet e Bordit të Bankës Qendrore dhe të marrin pjesë në diskutimet e tij pa të drejtë vote. Ndonjëherë, Kryesuesi mund të vendosë që mbledhjet e Bordit të Bankës Qendrore të mbahen pa Zëvendësguvernatorët.
10. Rregullat e punës së Bordit të Bankës Qendrore mund të lejojnë mbledhje dhe votime me anë të telekonferencës ose, në rrethana të jashtëzakonshme, me anë të mjeteve të verifikuara të komunikimit me shkrim apo elektronik.
11. Me kusht të plotësimit të kërkesës për kuorum të paragrafit 5 të këtij neni, asnjë akt apo procedim i Bordit të Bankës Qendrore nuk do të shfuqizohet duke u arsyetuar vetëm me ekzistencën e një apo më shumë posteve të lira në Bordin e Bankës Qendrore.
12. Të gjitha veprimet e çdo anëtari të Bordit të Bankës Qendrore do të mbeten valide, pavarësisht nëse zbulohet ndonjë parregullsi në emërimin, kualifikimin për t'u zgjedhur apo kualifikimet e përgjithshme të atij anëtari.

Neni 48 Procedimet

1. Procedimet e mbledhjeve të Bordit të Bankës Qendrore do të jenë konfidenciale. Bordi i Bankës Qendrore mund të vendosë të bëjë publik rezultatin e diskutimeve për çdo çështje.
2. Procesverbali i çdo mbledhjeje të Bordit të Bankës Qendrore do të nënshkruhet nga personi që kryeson mbledhjen si dhe Sekretari i Bordit të Bankës Qendrore.
3. Sekretari i Bordit të Bankës Qendrore do të emërohet nga Bordi i Bankës Qendrore me propozim të Guvernatorit. Sekretari do të jetë anëtar i personelit të Bankës Qendrore.

PJESA 3 MBLEDHJET DHE PROCEDIMET E BORDIT EKZEKUTIV

Neni 49 Mbledhjet

1. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv do të kryesohen nga Guvernatori apo nga Zëvendësguvernatori i parë në përputhje me vendimin mbi zëvendësimin të bërë sipas nenit 37, paragrafi 2 të këtij ligji.
2. Bordi Ekzekutiv do të mbledhet aq shpesh sa do të kërkohet nga veprimtaria e Bankës Qendrore por jo më pak se dy (2) herë në muaj.
3. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv do të thirren nga Guvernatori dhe gjithashtu mund të thirren me kërkesë me shkrim të përbashkët të Zëvendësguvernatorëve.
4. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv do të thirren duke komunikuar kohën, vendin si dhe agjendën e mbledhjes të gjithë anëtarët e Bordit Ekzekutiv sipas rregullave të procedurës të Bordit Ekzekutiv.
5. Kuorumi për punë në çdo mbledhje të Bordit Ekzekutiv do të përbëhet nga të paktën dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv.

6. Nëse kuorumi mungon, personi që kryeson mbledhjen mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme në të cilën mund të merren vendime pa marrë parasysh ekzistimin e kuorunit; vendimet e tilla duhet të ratifikohen në mbledhjen e rregullt të radhës të Bordit Ekzekutiv në mënyrë që të mbesin në fuqi.

7. Çdo anëtar i Bordit Ekzekutiv do të ketë një votë dhe në rast votash të barabarta, vota e personit që kryeson mbledhjen e përcakton rezultatin e votimit.

8. Përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj, vendimet e Bordit Ekzekutiv do të miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

9. Rregullat e punës së Bordit Ekzekutiv mund të lejojnë mbledhje dhe votime me anë të telekonferencës ose, në rrethana të jashtëzakonshme, me anë të mjeteve të verifikuara të komunikimit me shkrim apo elektronik.

10. Me kusht të plotësimit të kërkesës për kuorum të paragrafit 5 të këtij neni, asnjë akt apo procedim i Bordit Ekzekutiv nuk do të shfuqizohet duke u arsyetuar vetëm me ekzistencën e një apo më shumë posteve të lira në Bordin Ekzekutiv.

11. Të gjitha veprimet e çdo anëtari të Bordit Ekzekutiv do të mbeten valide, pavarësisht nëse zbulohet ndonjë parregullsi në emërimin, kualifikimin për t'u zgjedhur apo kualifikimet e përgjithshme të atij anëtari.

Neni 50 Procedimet

1. Procedimet e mbledhjeve të Bordit Ekzekutiv do të jenë konfidenciale. Bordi Ekzekutiv mund të vendosë të bëjë publik rezultatin e bisedimeve për çdo çështje. Do t'i publikojë menjëherë vendimet e veta sipas nenit 36, nën-paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3 të këtij ligji.

2. Procesverbali i çdo mbledhjeje të Bordit Ekzekutiv do të nënshkruhet nga personi që kryeson mbledhjen si dhe Sekretari i Bordit Ekzekutiv.

3. Sekretari i Bordit Ekzekutiv do të emërohet nga Bordi Ekzekutiv me propozim të Guvernatorit. Sekretari do të jetë anëtar i personelit të Bankës Qendrore.

PJESA 4 PERSONELI

Neni 51 Dispozitat e përgjithshme

1. Anëtarët e personelit do t'ia kushtojnë të gjitha shërbimet e tyre profesionale Bankës Qendrore, dhe nuk do të kenë post apo punësim tjetër, qoftë me apo pa pagesë, përveç si të emëruar të Bankës Qendrore apo për angazhime arsimore dhe civile me kusht që këto nuk pengojnë aftësinë për t'i shërbyer Bankës Qendrore, sidoqoftë, Bordi Ekzekutiv mund të vendosë të kufizojë apo ndalojë pjesëmarrjen në aktivitete të tilla të jashtme.

2. Bordi Ekzekutiv mund të miratojë politika dhe rregulla që devijojnë nga paragrafi paraparak, me qëllim të lehtësimit të emërimeve në pozita të punës me kohë të pjesshme.

3. Në punësim të personelit, Banka Qendrore do të aplikojë politikat të personelit të cilat nuk janë diskriminuese për sa i përket racës, etnisë, gjinisë apo religjionit.

Neni 52
Punësimi dhe përfundimi i marrëdhënies së punës

1. Guvernatori do të caktojë dhe ndërpresë punësimin e anëtarëve të personelit, të agjentëve dhe të korrespondentëve të Bankës Qendrore, brenda kufizimeve të, dhe në përputhje me, kushtet e përgjithshme për punësim, duke përfshirë edhe politikën e kompensimit, të miratuar nga Bordi Ekzekutiv.
2. Kompensimi që merret nga anëtarët e personelit të Bankës Qendrore do të avancojë interesat e Bankës Qendrore dhe do të jetë i tillë që të mund të rekrutohen dhe të mbahen anëtarë personeli të kualifikuar dhe me ekspertizë.
3. Asnjë kompensim i paguar nga Banka Qendrore nuk do të bazohet në fitimet apo në ndonjë të hyrë të Bankës Qendrore.

KREU XIII
DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 53
Njësia përlllogaritëse

Njësia përlllogaritëse për përgatitje të buxhetit të Bankës Qendrore, si dhe të pasqyrave financiare dhe të raportit të saj të referuar në nenin 59 të këtij ligji, do të jetë euro.

Neni 54
Llogaritë e rezervave

1. Banka Qendrore do të hapë dhe të mbajë një llogari të rezervave të përgjithshme. Llogaria e rezervave të përgjithshme nuk mund të përdoret përveçse për të mbuluar humbjet e pësuar nga Banka Qendrore.
2. Banka Qendrore do të hapë llogari të rezervave të rivlerësuara të përealizuara për të llogaritur fitimet dhe humbjet e përealizuara nga pozicionet e saja në valuta të huaja, ari, instrumente financiare dhe asete të tjera.
3. Banka Qendrore, pas konsultimit me Ministrin, mund të hapë llogari të rezervave speciale për shpenzime specifike të pritshme.

Neni 55
Fitimet, humbjet dhe të ardhurat e ndashme

1. Fitimet apo humbjet neto të Bankës Qendrore do të përcaktohen konform Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Ligjit për Raportimet Financiare.
2. Të ardhurat në dispozicion për t'u ndarë sipas nenit 56 të këtij ligji do të përcaktohen si vijon:
 - 2.1. duke zbritur nga fitimi neto shumë e gjithsejtë të fitimit të përealizuara nga rivlerësimet, dhe duke alokuar një shumë ekuivalente në llogarinë përkatëse të rezervave të rivlerësuara të përealizuara.
 - 2.2. duke zbritur nga llogaria përkatëse e rezervave të rivlerësuara të përealizuara dhe duke ua shtuar të ardhurave të ndashme të përcaktuara në nën-paragrafin 2.1. të këtij paragrafi

shumën e çdo fitimi të porealizuar që është zbritur nga fitimi neto të një apo më shumë viteve paraprake dhe është realizuar gjatë vitit financiar në fjalë.

3. Humbjet e porealizuara nga rivlerësimi do të transferohen në llogaritë përkatëse të rezervave të porealizuara nga rivlerësimi deri atëherë kur këto llogari ta arrijnë saldon zero, më pastaj këto humbje do të mbulohen nga fitimi i vitit në fjalë, më pas nga llogaria e rezervave të përgjithshme dhe më pas nga llogaria e kapitalit të autorizuar.

Neni 56

Alokimi i të ardhurave të ndashme

1. Brenda tridhjetë (30) ditëve pas publikimit të pasqyrave financiare të referuara në nenin 59, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.1. të këtij ligji, Banka Qendrore do të alokoj fitimin e ndashëm si vijon:

1.1. të gjitha të ardhurat e ndashme do të grumbullohen në llogarinë e rezervave të përgjithshme deri atëherë kur shuma e përgjithshme e kapitalit fillestar dhe rezervave të përgjithshme do të jetë barazi me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore;

1.2. më pastaj pesëdhjetë për qind (50%) e të ardhurave të ndashme do të transferohen në Ministri si të hyra për buxhetin e Shtetit dhe pesëdhjetë për qind (50%) do të alokohet në fondin e rezervave të përgjithshme të Bankës Qendrore.

2. Asnjë ndarje nuk do të bëhet nga të hyrat aktuale të Bankës Qendrore përveç siç lejohet sipas paragrafit paraprak.

3. Nëse në ndonjë vit financiar Banka Qendrore realizon të ardhura të ndashme negative, këto të ardhura së pari do mbulohen nga llogaria e rezervave të përgjithshme dhe më pastaj do të zbatohen ndaj llogarisë së kapitalit të autorizuar.

Neni 57

Mbulimi i rënies së kapitalit

1. Në rast se në pasqyrat financiare vjetore të audituara të Bankës Qendrore, vlera e aseteve të saj bie nën shumën e detyrimeve të saj dhe të kapitalit të autorizuar të pacenuar të saj, atëherë:

1.1. Bordi Ekzekutiv, me këshillim të auditorit të jashtëm të Bankës Qendrore, do të vlerësojë situatën dhe të përgatisë një raport mbi shkaqet dhe shkallën e rënies së kapitalit si dhe do të vlerësojë situatën brenda një periudhe jo më të gjatë se tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. në rast se Bordi i Bankës Qendrore e miraton raportin e përmendur më lart, Banka Qendrore do të kërkojë nga Ministri për një kontribut kapitali të bërë nga ana e Shtetit për të mbuluar deficitin; dhe

1.3. pas pranimi të kësaj kërkesë Shteti, brenda një periudhe jo më të gjatë se tridhjetë (30) ditë kalendarike, do t'i transferojë Bankës Qendrore shumën e nevojshme në para apo në instrumente të negociueshme të borxhit me një maturitet të specifikuar dhe të emetuara me norma interesi të lidhura me tregun.

Neni 58

Standardet e kontabilitetit

1. Banka Qendrore do t'i mbajë llogaritë dhe evidencat kontabël në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Ligjit për Raportimet financiare për të pasqyruar operacionet dhe gjendjen financiare të saj.

2. Viti financiar i Bankës Qendrore do të fillojë në ditën e parë kalendarike të janarit dhe do të përfundojë në ditën e fundit kalendarike të dhjetorit.

Neni 59 **Pasqyrat financiare dhe raportet vjetore**

1. Banka Qendrore duhet të përgatisë pasqyrat financiare për vitin e saj financiar.
2. Brenda gjashtë muajve pas mbylljes së çdo viti të saj financiar, Banka Qendrore duhet t'i dorëzoj Kuvendit të Republikës së Kosovës si dhe Ministrin një kopje të:
 - 2.1. pasqyrave financiare, të miratuara nga Bordi i Bankës Qendrore, të nënshkruara nga Guvernatori dhe të certifikuara nga auditori i jashtëm; dhe
 - 2.2. një raport, të miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore, lidhur me operacionet dhe punët e Bankës Qendrore gjatë vitit financiar që sapo ka përfunduar, posaçërisht në lidhje me objektivat e politikave të saj dhe ngjarjet që kanë ndikuar në ekonominë e Kosovës.
3. Pas përfundimit të tyre, Banka Qendrore do të publikojë pasqyrat financiare dhe raportin e referuar në paragrafin 2. të këtij neni.
4. Banka Qendrore do të përgatisë dhe të publikojë pasqyrat financiare përmbledhëse tremujore.
5. Banka Qendrore do të përgatisë dhe të publikojë bilancin mujor pro forma të gjendjes në fund të çdo muaji. Kopje të bilanceve të tilla të gjendjes do të publikohen dhe t'i dërgohen Ministrin.

Neni 60 **Emërimi i Shefit të Auditimit të Brendshëm**

1. Shefi i Auditimit të Brendshëm të Bankës Qendrore do të emërohet nga Guvernatori me miratimin e Bordit të Bankës Qendrore.
2. Shefi i Auditimit të Brendshëm do të jetë një person me përvojë të gjerë profesionale në fushën e kontabilitetit ose auditimit. Në emërimin e Shefit të Auditorit të Brendshëm do të aplikohen kriteret e dhëna në nenin 40 dhe nenin 41 të këtij ligji.
3. Shefi i Auditimit të Brendshëm do të emërohet për një mandat prej gjashtë (6) vjetësh, që mund të përsëritet. Asnjë person nuk mund të shërbejë si Shef i Auditimit të Brendshëm për më shumë se dymbëdhjetë (12) vjet.
4. Shefi i Auditimit të Brendshëm mund të japë dorëheqje duke e njoftuar për këtë Guvernatorin jo më pak se tre muaj para dorëheqjes.
5. Shefi i Auditimit të Brendshëm do të shkarkohet nga posti nëse Bordi i Bankës Qendrore vjen në përfundim se kushtet e referuara në nenin 41, paragrafi 1. të këtij ligji, në lidhje me diskualifikimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore, janë përmbushur në lidhje me Shefin e Auditimit të Brendshëm. Po ashtu, Shefi i Auditimit të Brendshëm mund të shkarkohet me vendim të Bordit të Bankës Qendrore nëse Bordi i Bankës Qendrore vjen në përfundim se ai ose ajo ka plotësuar një apo më shumë nga kriteret për shkarkim të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore për arsye të përmendura në nenin 41, paragrafi 2 të këtij ligji.
6. Bordi i Bankës Qendrore do të përkufizojë fushëveprimin dhe kushtet dhe kriteret e auditimit të brendshëm në Statutin e Auditimit të Bankës Qendrore.

Neni 61

Detyrat e Shefit të Auditimit të Brendshëm

1. Detyrat e Shefit të Auditimit të Brendshëm, në rast nevoje i ndihmuar nga auditorët tjerë të brendshëm do të përfshijnë:

1.1. rishikime dhe rekomandime për Bordin e Bankës Qendrore, Bordin Ekzekutiv dhe Komitetin e Auditimit, rreth procedurave dhe praktikave për menaxhimin e duhur të rrezikut dhe, pasi këto procedura dhe praktika të jenë përcaktuar, edhe mbikëqyrje të zbatimit të tyre në baza të vazhdueshme;

1.2. realizim të auditimeve periodike të administrimit dhe operacioneve të Bankës Qendrore për të siguruar respektimin e mbikëqyrjes së duhur nga Banka Qendrore të ligjeve si dhe të vendimeve të organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore që janë të aplikueshme për të;

1.3. rishikim të pasqyrave financiare periodike të referuara në nenin 59, paragrafët 2 dhe 4 të këtij ligji, si dhe të dokumenteve të Bankës Qendrore që kanë të bëjnë me to;

1.4. përgatitje dhe dorëzime në Bordin e Bankës Qendrore, kurdo që konsiderohet e duhur nga Bordi i Bankës Qendrore apo Komiteti i Auditimit, por të paktën një herë në çdo tremujor, të raporteve dhe rekomandimeve që kanë të bëjnë me evidencat dhe pasqyrat financiare, procedurat buxhetore dhe kontabël, menaxhimin e rrezikut dhe kontrolleve të tjera të zbatuara nga Banka Qendrore, të efikasitetit dhe rentabilitetit me të cilët vepron Banka Qendrore, si dhe të çdo çështjeje tjetër brenda kompetencave dhe fushës së përgjegjësive për të cilën një raport mund të kërkohet nga Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv apo Komiteti i Auditimit;

1.5. këshillim të Guvernatorit në rekrutimin e auditorëve të brendshëm;

1.6. çdo detyrë tjetër e cila mund kërkohet nga Bordi i Bankës Qendrore apo Komiteti i Auditimit, me kusht që këto detyra të mos pengojnë në detyrat kryesore të parashtruara këtu; dhe

1.7. komunikim dhe mbajtje kontakti me auditorët e jashtëm të Bankës Qendrore.

Neni 62

Komiteti i Auditimit

1. Bordi i Bankës Qendrore do të emëroj Komitetin e Auditimit prej tre (3) anëtarësh.

2. Bordi i Bankës Qendrore i zgjedh dy (2) anëtarë joekzekutivë nga radhët e veta, ndërsa anëtari i tretë (3) i Komitetit të Auditimit do të jetë ekspert i jashtëm kompetent në fushën e kontabilitetit ose të auditimit.

3. Anëtari i referuar në paragrafin 2. të këtij neni do të shkarkohet nga posti nëse Bordi i Bankës Qendrore del në përfundim se kushtet e përcaktuara në nenin 41, paragrafi 1, në lidhje me diskualifikimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore, janë përmbushur lidhur me këtë anëtar të Komitetit të Auditimit. Po ashtu, ky anëtar i Komitetit të Auditimit mund të shkarkohet me vendim të Bordit të Bankës Qendrore nëse Bordi i Bankës Qendrore del në përfundim se ai ose ajo ka plotësuar një apo më shumë nga kriteret për shkarkim të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore për shkaqet e përcaktuara në nenin 41, paragrafi 2 të këtij ligji.

4. Me ftesë të Komitetit të Auditimit, njëri nga anëtarët e Bordit Ekzekutiv apo anëtarët e personelit mund të marrin pjesë në mbledhjen e komitetit, pa të drejtë vote.

5. Përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit duhet të përfshijnë:

- 5.1. mbikëqyrja e funksionimit të auditimit të brendshëm;
 - 5.2. rekomandime lidhur me caktimin e auditorëve të jashtëm dhe fushë veprimtarinë e auditimeve të jashtme dhe shërbimeve të tjera;
 - 5.3. takime me auditorët për të diskutuar rezultatet e tyre; ose
 - 5.4. rishikime me auditorët e jashtëm të pasqyrave financiare të fund vitit.
6. Bordi i Bankës Qendrore do të përcaktojë përbërjen, përgjegjësitë dhe detyrat e mëtejme të Komitetit të Auditimit në statutin e Komitetit të Auditimit të Bankës Qendrore.
 7. Komiteti i Auditimit do t'i raportojë periodikisht Bordit të Bankës Qendrore.
 8. Komiteti i Auditimit mund t'i rregullojë veprimtarinë e vetë, duke iu përmbajtur çdo kërkesë të këtij ligji dhe çdo urdhërese që i jepet atij nga Bordi i Bankës Qendrore.

Neni 63 Auditimi i jashtëm

1. Llogaritë, evidencat dhe pasqyrat financiare të Bankës Qendrore, të paktën një herë në vit, do të auditohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit nga auditorë të jashtëm të pavarur ndërkombëtar të cilët duhet të kenë reputacion të mirë dhe përvojë ndërkombëtare të njohur në auditimin e institucioneve të mëdha financiare ndërkombëtare.
2. Bordi i Bankës Qendrore do të emëroj auditorët e jashtëm pas aprovimit nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Asnjë auditor i jashtëm nuk do të emërohet në vazhdimësi për një periudhë të vazhdueshme më të gjatë se pesë (5) vjet, pas kësaj periudhe firma e auditimit duhet të ndërrohet.
3. Bordi i Bankës Qendrore mund të përjashtojë auditorët e jashtëm të Bankës për shkaqe të arsyeshme pas konsultimeve me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike duke theksuar shkaqet e arsyeshme që përbëjnë bazën e përjashtimit.
4. Auditori i jashtëm do t'i raportojë Komitetit të Auditimit për çështjet kyçe që dalin nga auditimi dhe në veçanti për mangësitë materiale në kontrollet e brendshme në lidhje me procesin e raportimit financiar.
5. Auditorët e jashtëm do të kenë kompetencë të plotë për të inspektuar nga afër të gjitha librat dhe llogaritë e Bankës Qendrore dhe për të marrë të gjitha informacionet për transaksionet e saj.
6. Raporti i auditorëve të jashtëm do të publikohet.

Neni 64 Buxheti

1. Banka Qendrore do të përgatisë buxhetin e saj vjetor , i cili do të miratohet nga Bordi i Bankës Qendrore, para fillimit të çdo viti financiar.
2. Të gjitha të hyrat dhe të ardhurat e projektuara për t'u gjeneruar nga Banka Qendrore apo për t'iu dhënë Bankës Qendrore nga cilido burim bashkë me shpenzimet e projektuara, duke përfshirë zhvlerësimin dhe provizionet për humbje, do të përfshihen në buxhetin vjetor.
3. Buxheti vjetor i miratuar do t'i komunikohet për qëllim informimi Ministrit të Financave.

4. Bordi Ekzekutiv do të miratojë urdhëresa të brendshme për zbatimin e buxhetit të Bankës Qendrore.

KREU XIV DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 65 Instrumentet rregullatore

1. Banka Qendrore do të ketë kompetencë të nxjerrë Rregullore, Udhëzime, dhe Urdhra ashtu si do të jetë e nevojshme për realizimin e detyrave që i janë besuar Bankës Qendrore me këtë ligj apo ndonjë ligj tjetër.

2. Rregulloret dhe Udhëzimet e nxjerra nga Banka Qendrore do të kenë aplikim të përgjithshëm. Ato do të jenë të detyrueshme në tërësinë e tyre dhe drejtpërdrejt të aplikueshme.

3. Një Urdhër i nxjerrë nga Banka Qendrore do të jetë i detyrueshëm për personin të cilit i adresohet.

4. Organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore do të miratojnë të gjitha instrumentet e nevojshme rregullatore që kanë të bëjnë me çështjet brenda fushave përkatëse të kompetencës së tyre.

Neni 66 Publikimi i instrumenteve rregullatore

1. Rregulloret e nxjerra nga Banka Qendrore do të publikohen në ueb faqen e saj dhe do të hyjnë në fuqi në datën e publikimit të tillë apo në ndonjë datë të mëvonshme ashtu si përcaktohet në vetë Rregulloren.

2. Udhëzimet e nxjerra nga Banka Qendrore do të publikohen në ueb faqen e saj dhe do të hyjnë në fuqi në datën e përcaktuar në vetë Udhëzimin.

3. Bordi i Bankës Qendrore mund të vendosë për publikimin e Urdhrave.

4. Banka Qendrore do të mbajë një regjistër publik të Rregulloreve dhe Udhëzimeve të saj të publikuara.

Neni 67 Ndëshkimet administrative

1. Bordi Ekzekutiv, me anë të vendimeve, mund të shqiptoj ndëshkime administrative ndaj të gjithë personave juridikë apo fizikë që veprojnë në kundërshtim me këtë ligj.

2. Ndëshkimet administrative përfshijnë ndëshkimet monetare si dhe masa të tjera administrative, si vërejtjet apo urdhrat me shkrim, suspendimet dhe largimet e administratorëve të institucioneve financiare të mbikëqyrura, revokimet e licencave si dhe masa të tjera ashtu si përcaktohen në këtë ligj apo ndonjë ligj tjetër.

3. Ndëshkimet monetare mund të shqiptohen, sipas gjykimit të Bankës Qendrore, në shumat deri në pesëmbëdhjetëmijë (15,000) euro për shkelje, përderisa nuk përcaktohet ndryshe në ndonjë ligj tjetër. Ato mund të shqiptohen në baza ditore për çdo ditë që shkelja vazhdon derisa Banka Qendrore të përcaktojë se pajtueshmëria e kërkuar është arritur.

4. Para së të shqiptojë ndëshkime administrative, Bordi Ekzekutiv do të ofrojë një deklaratë të detajuar ndaj personit të cilit do t'i shqiptohet ndëshkimi duke përshkruar faktet dhe ligjin që

mbështesin ekzistencën e shkeljes, dhe do t'i japë këtij personi mundësi të plotë të ofrojë fakte dhe argumente se pse ndëshkimi nuk do të duhej t'i shqiptohej.

5. Bordi Ekzekutiv nuk kërkohet të zbatojë paragrafin 4. të këtij neni kur përcakton ndëshkimet e përmendura në nenin 12, paragrafi 3, nenin 23, paragrafi 1 dhe nenin 25 të këtij ligji.

6. Bordi i Bankës Qendrore do të nxjerrë rregullore në të cilën parashtron procedurat që do të ndjekë në lidhje me shqiptimin e ndëshkimeve administrative.

7. Në përcaktimin lidhur me shqiptimin e ndëshkimeve administrative, si dhe në përcaktimin e shkallës së ndëshkimit të tillë, Bordi Ekzekutiv do të marrë në konsideratë: seriozitetin e shkeljes; nëse ajo është përsëritur ose jo; nëse nga ajo depozituesit apo personat e tjerë janë dëmtuar; nëse nga veprimi në fjalë personi ndaj të cilit ndëshkimi shqiptohet ka përfituar ose jo; resurset financiare të këtij personi; çdo faktor lehtësues; dhe çdo faktor tjetër që, sipas gjykimit të Bankës Qendrore, besohet të jetë relevant.

8. Shqiptimi nga Bordi Ekzekutiv i ndëshkimeve administrative të përcaktuara në këtë nen nuk do të përjashtojë shqiptimin e çdo përgjegjësie civile apo penale sipas dispozitave të çdo ligji.

Neni 68

Standardet e administrimit të mirë

1. Bordi i Bankës Qendrore dhe Bordi Ekzekutiv do të ushtrojë kompetencat që u janë dhënë në mënyrë të barabartë dhe të njëtrajtshme si dhe në përputhje me praktikat e qëndrueshme administrative. Ata nuk do të ushtrojnë asnjë kompetencë të tillë në shërbim të ndonjë objekti për të cilin ajo kompetencë nuk u është dhënë ose të tejkalojnë ushtrimin e një kompetencë në arritjen e objektivit për të cilin ajo kompetencë u është dhënë.

2. Vendimet e Bordit të Bankës Qendrore dhe Bordit Ekzekutiv do të jenë të paanshme dhe të motivuara vetëm nga konsideratat objektive dhe racionale. Ato do të zbatohen me arsyeshmëri dhe maturi.

Neni 69

Konflikti i interesit dhe detyrat e mirëbesimit

1. Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe personeli i Bankës Qendrore kanë detyrë mirëbesimi ndaj Bankës Qendrore dhe ndaj klientëve të saj për të vënë interesat e Bankës Qendrore dhe interesat e klientëve të saj para interesave të veta.

2. Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe personelit të Bankës Qendrore do të shmangin çdo situatë që ka të ngjarë të çojë në një konflikt të interesit. Një konflikt i interesi lind kur anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe personeli i Bankës Qendrore kanë interesa private apo personale që mund të ndikojnë apo duken të ndikojnë në realizimin e paanshëm dhe objektiv të detyrave të tyre. Interesat private apo personale të anëtarëve të organeve vendimmarrëse dhe personelit të Bankës Qendrore nënkuptojnë çdo avantazh të mundshëm për veten e tyre, familjen e tyre, të afërmeve të tyre deri në rendin e dytë apo rrethin e tyre të miqve dhe të njohurve. Nëse një (1) anëtar i Bordit të Bankës Qendrore ose Bordit Ekzekutiv e gjejnë veten në një situatë ku ka gjasa të sjellin një konflikt të interesit kërkohet që menjëherë të njoftoj anëtarët e tjerë dhe të largoj veten nga çdo diskutim apo vendim që ka të bëjë me ndonjë çështje ose konflikt të interesit.

3. Guvernatori dhe Zëvendësguvernatorët do të realizojnë detyrat e tyre me orar të plotë. Asnjë nga anëtarët e Bordit Ekzekutiv nuk do të angazhohet në ndonjë punë tjetër, qoftë fitimprurëse ose jo, përveç në ato raste të jashtëzakonshme kur Bordi i Bankës Qendrore lejon një përjashtim nga ky kufizim.

4. Anëtar i organeve vendimmarrëse dhe personelit të Bankës Qendrore nuk do të marrë apo të pajtohet të marrë nga ndonjë burim ndonjë përfitim, kompensim apo dhuratë që tejkalon një shumë të rëndomtë apo të parëndësishme, qoftë financiare apo jofinanciare, në rastin kur ky përfitim, kompensim apo dhuratë është e lidhur në çfarëdo mënyre me aktivitetet e tyre brenda Bankës Qendrore.

5. Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe personeli i Bankës Qendrore nuk do të përdorin informacion konfidencial në të cilin ata kanë qasje për qëllim të realizimit të transaksioneve financiare private, qoftë direkt apo indirekt nëpërmjet palëve të treta, apo qoftë me rrezik dhe për llogari të vet apo me rrezik dhe për llogari të një pale të tretë.

6. Anëtarët e organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore çdo vit para ditës së fundit të janarit do t'i shpallin plotësisht Bordit të Bankës Qendrore interesat e rëndësishëm financiar që ai vet apo çdo person me të cilin ai ka lidhje familjare, afariste, apo financiare mundet të posedojë direkt apo indirekt, dhe një shpallje e tillë do të bëhen në pajtim me çdo rregull të brendshëm të aprovuar nga Bordi i Bankës Qendrore për çështje të tilla.

7. Sa herë që një çështje e lidhur me interes të tillë apo interes tjetër personal që çon apo mund të çojë në konflikt të interesit paraqitet para Bordit të Bankës Qendrore apo Bordit Ekzekutiv, anëtari përkatës do të shpallë interesin e vet në fillim të diskutimit dhe nuk do të marrë pjesë në diskutim dhe marrjen e vendimit për këtë çështje; sidoqoftë, prania e tij ose e saj do të vlejë për qëllim të konstituimit të kuorumit.

8. Thyerja e dispozitave të këtij neni nga një anëtar i organeve vendimmarrëse apo personelit të Bankës Qendrore përbën sjellje të keqe serioze. Kur ka të bëjë me një anëtar të organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore, sjellja e tillë përbën një sjellje të keqe serioze brenda kuptimit të nenit 40, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.4 të këtij ligji. Një sjellje e tillë e keqe kur ka të bëjë me një anëtar të personelit, sipas gjykimit të Guvernatorit, mundet të përbëjë bazën për masa disiplinore.

9. Bordi i Bankës Qendrore mund të përcaktojë rregulla të brendshme për të zbatuar kërkesat e përmendura në paragrafët paraprakë.

Neni 70 Tarifat dhe ngarkesat

Banka Qendrore mund të caktojë tarifa dhe ngarkesa të arsyeshme për shërbimet që ofron dhe detyrat që kryen. Këto tarifa dhe ngarkesa do të publikohen.

Neni 71 Aktivitetet e ndaluara

1. Përveç nëse me ligj në mënyrë specifike autorizohet ndryshe, Banka Qendrore nuk do:

1.1. të japë ndonjë kredi apo të jap ndonjë dhuratë domethënëse monetare apo financiare;

1.2. të merret me tregti, të blejë aksionet e ndonjë korporate, duke përfshirë aksionet e ndonjë institucioni financiar, apo në mënyrë tjetër të ketë interes pronësor në ndonjë ndërmarrje financiare, komerciale, bujqësore, industriale apo tjetër; ose

1.3. të fitojë me anë të blerjes, marrjes me qira apo ndonjë mënyre tjetër ndonjë të drejtë në pronë të paluajtshme, përveç kur e konsideron të nevojshme ose të përshtatshme për sigurimin e objekteve për realizimin e administrimit dhe operacioneve të saj ose për kërkesa të ngjashme që dalin nga kryerja e detyrave të saj.

2. Pavarësisht nga dispozitat paraprake të këtij neni, Banka Qendrore mund;

- 2.1. të japë kredi të siguruara në mënyrë adekuate për, ose të ketë aksione pronësie ose ndryshe të marrë pjesë në, ndonjë organizatë që është e angazhuar në aktivitete që kërkohen apo janë të dobishme për realizimin e duhur të detyrave dhe përgjegjësi të Bankës Qendrore;
 - 2.2. të fitojë, në procesin e shlyerjes së borxheve ndaj saj, çdo interes apo të drejtë të referuar në këtë nen; me kusht që, sidoqoftë, të gjitha interesat apo të drejtat e fituara në këtë mënyrë do të shiten në momentin e parë më të përshtatshëm; dhe
 - 2.3. themelojë fonde pensionale për personelin apo aranzhmane të ngjashme për përfitim apo mbrojtje të personelit, dhe menaxhojë fondet dhe aranzhmanet e tilla.
3. Çdo aktivitet i tillë i përmendur në paragrafin 2 do të publikohet nga Banka Qendrore në raportin e referuar në nenin 59, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.2. të këtij ligji

Neni 72 Imuniteti ndaj të tatuarit

1. Banka Qendrore do të përjashtohet nga të gjitha tatimet në të ardhurat e saj si dhe nga të gjitha doganat, akcizat dhe detyrimet e tjera mbi importin dhe furnizimin vendor të arit, kartëmonedhave dhe monedhave.
2. Banka Qendrore do të përjashtohet nga të gjitha tatimet, doganat dhe detyrimet e tjera prej të cilave ministrinë e Qeverisë dhe agjencitë e tjera publike janë të përjashtuara me ligj.

Neni 73 Mjedisi ligjor

1. Në rast se dispozitat e këtij Ligji bien ndesh me ato të ligjeve të tjera, atëherë dispozitat e këtij Ligji do të mbizotërojnë.
2. Banka Qendrore nuk do t'i nënshtrohet asnjë dispozite ligjore që do të vështirësonte arritjen e objektivave të Bankës Qendrore, të referuara në nenin 7, paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji, si dhe realizimin e detyrave të saj të lidhura me to. Në veçanti, Banka Qendrore nuk do t'i nënshtrohet ligjeve në vijim: Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligji mbi Prokurimin Publik, Ligji mbi Auditimin e Brendshëm, dhe Ligji mbi themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrën e Auditorit të Kosovës.
3. Dispozitat e këtij ligji nuk do të revokohen, anulohen, ndryshohen apo zëvendësohen, tërësisht ose pjesërisht, nga ligje të tjera, përveç nëse legjislacioni i pastajmë ndryshon në mënyrë specifike këtë ligj, dhe çdo ndryshim i tillë do të kërkojë konsultime paraprake me Bankën Qendrore.

Neni 74 Konfidencialiteti

1. Asnjë person që shërben ose ka shërbyer si anëtar i Bordit të Bankës Qendrore, Bordit Ekzekutiv, apo personelit të Bankës Qendrore, përveç kur paraqitet nevoja për të përmbushur ndonjë detyrë ose detyrim të imponuar nga ky ligj apo ndonjë ligj tjetër, nuk do të lejojë qasje në, të shpalosë apo të publikojë informacionin jopublik që ai/ajo e ka marrë gjatë realizimit të detyrave të punës apo ta përdorë këtë informacion a të lejojë këtë informacion të përdoret për përfitim personal.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni personat e tillë mund të shpalosin informacionin jopublik jashtë Bankës Qendrore, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Bordi Ekzekutiv, nëse shpalosja e tillë:

- 2.1. bëhet në përputhje me pëlqimin e qartë të personit fizik apo juridik me të cilin ka të bëjë informacioni;
 - 2.2. përmbush një detyrim për zbulimin e përcaktuar sipas ligjit penal, duke përfshirë ndihmësen për zbatimin e ligjit penal ose me urdhër të gjykatës që ka të bëjë me raste penale;
 - 2.3. bëhet për auditorët e jashtëm të Bankës Qendrore;
 - 2.4. jepet për autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse ose institucionet publike financiare ndërkombëtare, për realizim të detyrave të tyre zyrtare; ose
 - 2.5. nevojitet për interesa të vetë Bankës Qendrore në procedurë gjyqësore që kërkon shpalosje.
3. Bordi Ekzekutiv në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të këtij ligji, duhet të përcaktojë klasifikimin dhe qasjen në dokumentet e mbajtur apo të hartuar nga Banka Qendrore.

Neni 75 **E drejta e përparësisë**

1. Banka Qendrore do të ketë të drejtë përparësie të prioritetit parësor të pakushtëzuar për përmbushjen e të gjitha kërkesave të saj që dalin nga ekzekutimi i detyrave të saj prej çdo saldo të parave, letrave me vlerë të borxhit dhe asetëve të cilat ajo i mban për llogari të debitorit në fjalë, qoftë si kolateral për të siguruar kërkesat e saj ose në mënyrë tjetër, në çastin kur këto të kërkesa bëhen të detyrueshme dhe të pagueshme.
2. Banka Qendrore mund të ushtrojë të drejtën e përparësisë të saj vetëm përmes përvetësimit të saldosh të parave përmes kompensimit dhe përmes shitjes së letrave me vlerë dhe asetëve të tjera pa vonesa të pajustificueshme në një mënyrë komercialisht të arsyeshme dhe pagimit të vetës nga mjetet prej shitjes pasi të ketë zbritur nga to kostot e lidhura me shitjen.
3. Asnjë veprim i gjykatës apo veprim i ndonjë subjekti publik nuk do të kërkohet, dhe asnjë e drejtë konkurruese nuk do të lejohet, për të shtyrë ushtrimin nga Banka Qendrore të së drejtës së saj të përparësisë në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 76 **Imuniteti ndaj caktimit të masës së përkohshme gjyqësore**

1. Asnjë ndalesë apo ekzekutim nuk mund të shqiptohet ndaj Bankës Qendrore apo pronës së saj, duke përfshirë arin, të drejtat e veçanta të tërheqjes, paratë e gatshme, paratë në llogari, depozitat ose letrat me vlerë, si dhe çdo të ardhur nga to, para shqiptimit të vendimit përfundimtar në çdo veprim ligjor të parashtruar para gjykatave të Kosovës.
2. Banka Qendrore mundet, plotësisht ose pjesërisht, të heqë dorë nga kjo mbrojtje, në mënyrë të qartë dhe me shkrim, me përjashtim të arit dhe të Drejtat e Veçanta të Tërheqjes që mbahen në llogarinë e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Neni 77 **Shqyrtimet gjyqësore**

1. Në çfarëdo procedure gjyqësore apo të arbitrazhit kundër Bankës Qendrore, një anëtar i organeve vendimmarrëse apo personelit të Bankës Qendrore apo një agjent i Bankës Qendrore, në lidhje me realizimin e detyrave të tyre ndaj Bankës Qendrore:

1.1. gjykata ose paneli i arbitrazhit në marrjen e vendimit të tij mund të shqyrtojë nëse i pandehuri ka vepruar në kundërshtim me ligjin ose në mënyrë arbitrare apo kapricoze duke marrë në konsideratë faktet dhe ligjet dhe rregulloret relevante;

1.2. një anëtar i organeve vendimmarrëse apo personelit të Bankës Qendrore, apo një agjent i Bankës Qendrore, duke përfshirë një person i cili dikur ka qenë në një pozitë të tillë, nuk do të jetë përgjegjës për dëme apo përgjegjës për vepra a lëshime që kanë ndodhur bazuar në dhe në proces të realizimit të detyrave dhe përgjegjësi në emër të Bankës Qendrore përveç nëse provohet që këto vepra a lëshime përbejnë sjellje të paligjshme me dashje apo neglizhencë serioze;

1.3. procedura në fjalë do të vazhdoj pa kufizime gjatë periudhës së një ankese si dhe çdo ankesë të mëtejme apo procedura të tjera gjyqësore që kanë të bëjnë me ankesë; dhe

1.4. gjykata apo paneli i arbitrazhit do të jetë i autorizuar, në rastet e duhura, të caktojë dëmshpërblime monetare për palën e dëmtuar, por nuk do të ndalojë, të pezullojë, të suspendojë apo të shfuqizojë veprimet e marra nga Banka Qendrore.

Neni 78

Dëmshpërblimi për shpenzimet e procedurave gjyqësore

Banka Qendrore do të dëmshpërblejë një anëtar të organeve vendimmarrëse të Bankës Qendrore apo personelit të saj, apo një agjent të saj për shpenzimet e shkaktuara në mbrojtje të një veprimi ligjor të ngritur kundër këtij personi në lidhje me kryerjen apo kryerjen e supozuar të detyrave zyrtare brenda lëmit të punësimit apo angazhimit të tij sipas këtij ligji, me kusht që një dëmshpërblim i tillë të mos aplikohet nëse ky person është dënuar për një krim që del nga aktivitetet e mbuluara me këtë veprim ligjor.

KREU XV DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 79

Emërimi i anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore

1. Në datën kur ky ligj hyn në fuqi, Guvernatori dhe anëtarë të tjerë të Bordit Drejtues të themeluar sipas Ligjit nr 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, do të konsiderohen të jenë emëruar si anëtarë të Bordit të Bankës Qendrore në përputhje me këtë Ligj dhe do të vazhdojnë të shërbejnë gjatë mandateve përkatëse.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit do të shërbej një mandat të vetëm prej pesë (5) vitesh nga dita e miratimit të këtij ligji. Më pastaj, Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit do të pushoj të jetë anëtar i Bordit të Bankës Qendrore. Pasi që Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit pushon të jetë anëtar do të emërohet një anëtar shtesë jo-ekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore.

3. Në fund të mandateve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, çdo emërim i ri do të bëhet në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

4. Në të njëjtën datë të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, Zëvendësguvernatorët e emëruar sipas Ligjit Nr 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës do të konsiderohen të jenë emëruar si anëtarë të Bordit Ekzekutiv në përputhje me këtë Ligj dhe do të vazhdojnë të shërbejnë gjatë mandateve përkatëse të mbetura. Emërimet pasuese do të bëhen në përputhje me nenin 38 të këtij ligji.

5. Në të njëjtën datë të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, Inspektori i Përgjithshëm i emëruar sipas Ligjit nr 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës do të konsiderohet të jetë

emëruar si Shef i Auditimit të Brendshëm në përputhje me këtë ligj dhe do të vazhdojë të shërbejë gjatë mandatit të tij të mbetur. Emërimet pasuese do të bëhen në përputhje me nenin 60 të këtij ligji.

KREU XVI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 80 Ndikimi në dispozitat e mëparshme ligjore

1. Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ligji nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës do të revokohet.
2. Rregullat dhe instrumentet e tjera rregullatore në fuqi sipas Ligjit nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës do të mbeten në fuqi derisa ato të zëvendësohen nga Rregullore dhe Instruksione të miratuara në përputhje me këtë ligj.

Neni 81 Hyrja në fuqi

Ky ligj hynë në fuqi ditën e shpalljes nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-209
22 korrik 2010**

Shpallur më Vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03-V-392, datë 27 korrik 2010.